

AKT
MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT TE
SHOQERISE "ILIRIA-98" SH.P.K TIRANE

Ne zbatim te misionit qe me eshte besuar nga Keshilli Drejtues I shoqerise "ILIRIA-98" sh.p.k .Tirane per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise, kam nderin t!ju paraqes aktin e meposhtem:

Shoqeria "ILIRIA-98" shpk Tirane eshte rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 19019 date 12 .03 1998, me objekt "kembime valutore, me ortak te vetem z. Ndricim Shehaj, me kapital themeltar 2 500 000 leke.

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 19019 date 25 11 1998 shoqeria ka kaluar ne pronsi te ortakut te vetem z. Shefqet Dizdari, pa ndryshuar Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise.

Me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 19019/2 dhe 6393 date 1.04.1999 eshte bere depozitimi ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane, vendimi nr 1 date 31 Mars 1999 i ortakut te vetem te shoqerisea "ILIRIA-98" shpk z. Shefqet Dizdari, per shitjen 100 % te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerije me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e saj z. Edmond Ymeri, Ali Topalli dhe Ilir Janku.

Sipas ketij vendimi, ortake dhe adminstratore te kesaj shoqerije, ne pjese te barabararta 33,3 % seicili, do te jene z. Edmond Ymeri, Ali Topalli, Ilir Janku.

Akti I Themelimit te shoqerise dhe Statuti I saj kane mbetur ato te hartuara me rregjistrimin e shoqerise.

Per kyerjen e misionit qe mu ngarkua, Ne zbatim te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr 7661 date 19.01.1993 "Per kontabilitetin" shqyrtova dokumentacionin perkates si me poshte:

- Dokumentat ligjore te krijimit te shoqerise; Vendimin e Gjykates, Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise.
- Dokumentacionin ligjor te kalimit te pronsise se shoqerise ortakeve te sotem.
- Bilancin kontabel dhe anekset parktese date 31.12.2003.
- Vendimin e ortakeve nr. 8/8 date 15.03.2004 per rritjen e kapitalit me anen e kontributeve ne natyre ne menyre proporcionale nga seicili ortak, 33,3% te vleres

JF

gjithej te kontributeve ne natyre te cilat te gjitha se bashku kapin vleren 2 683 730 leke.

Vendimin e Ortakeve nr. 8/20 date 20.03.2004 per shtesen e kapitalit per derdhjet e bera nga ortaket ne fondet e shoqerise ne vite ne masen 6 232 691 leke(4 757 263 + 1 475 428).

Nga shqyrtimi I Vendimeve te ortakeve per rritjen e kapitalit konstatova se ato jane te plota dhe te mbeshtetura ne dokumentacionin perkates.

Konkretisht ne vendimin per rritjen e kapitalit me anen e kontributeve ne natyre citohen objektet qe perfshihen ne kapital dhe vlerat perkatese te seicilit te dokumentuara me fatura te rregullta nga subjektet qe I kane shitur ato. Shtesa e kapitalit nga keto kontribute ne vleren 2 683 730 leke do sjelle rritjen e kapitalit ne te njeten mase si dhe rritjen e aktiveve te shoqerise ne postin: "Aktive te Qendrueshme te trupezuara".

Vendimi tjetër I ortakeve per rritjen e kapitalit me anen e derdhjeve te bera nga shoqeria ne vite per 4 757 263 leke dhe 1 475 428 leke eshte nje veprim I realizuar ne fakt dhe qe ortaket kerkojne ti depozitojne shumat perkatese ne kapitalin e shoqerise. Shumat ne fjale paraqiten ne pasiv te bilancit ne rubrikat ortaket per 4 757 263 leke dhe ne rubriken kapitali themeltar per leke 1475 428 leke e cila i eshte shtuar me veprim kontabel kapitalit te nenshkruar ne krijim te shoqerise per 2 500 000 leke. Rritja e kapitalit me anen e ketyre kontributeve nuk ndryshon aktivet e shoqerise, por kryhen transaksionet perkatese brenda llogarive te pasivit te bilancit.

Perfundimi

Me vendimet e mesiperme te asamblerse se ortakeve kapitali I nenshkruar peson ndryshimet e meposhtme:

- Kapitali I nenshkruar sipas dokumentave te krijimit te shoqerise	leke	2 500 000	-
- Shtuar kapitali me veprime kontabile (pa vendim Gjykate)	"	1 475 428	-
- Derdhur nga ortaket, paraqitur ne llog. "Ortaket"	"	4 757 263	+
- Shtesat ne natyre te kapitalit sipas Vendimit te ortakeve 15.3.04	"	2 683 730	+
- Zbritje per llogari te rezervave te tjera per efekt rumbullakimi	"	(16 421)	-
- Githsej madhesia e kapitalit	"	11 400.000	

Ne mbyllje ritheksojme se madhesija e kapitalit te Shoqerise "ILIRIA-98" shpk behet 11 400 000 leke e cila eshte e perbere nga kapitali I nenshkruar me krijimin e shoqerise 2 500 000 dhe nga rritja si pasoje e zmadhimit te kapitalit ne masen 8 900 000 leke.

Ekspert Kontabel I Autorizuar

Hilmi Shtepani

Ekspert Kontabel i Autorizuar

HILMI SHTEPANI

Licensa nr.18 date 10 2. 2000 TIRANË ALBANIA

Tirane , me 10.08.2004